

Kriteret do të bëhen publike para vlerësimit dhe do të konsultohen me palët e interesit

# BB jep 400 milionë USD për rrugët dytësore

*Projekti do të zbatohet për 5 vjet dhe parashikohet të ngrihet dhe një rrjet komunal të përmirësuar*


Silvana Balliu

*Banka Botërore dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të zbatojnë projektin me vlerë vlerë 400 milionë USD, për ndërtimin e rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri.*

Zëvendëskryeministri Gazmend Oketa, në cilësinë e kryetarit të bordit të FSHZH-së, bëri me dije se "ky është një projekt ambicioz i qeverisë shqiptare i mbështetur nga BB dhe që do të realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Me anë të këtij projekti qeveria do të synojë të rrisë përpjekjet konkrete për përmirësimin e infrastrukturës në vend si edhe për shtimin e aksesit ndaj shërbimeve themelore dhe tregjeve ekonomike, veçanërisht në zonat rurale".

## Projekti

Në fund të këtij projekti, i cili do të zgjasë 5 vjet, parashikohet të ngrihet jo vetëm një rrjet dytësor dhe komunal i përmirësuar në mënyrë rrënjësore, por edhe një inventar i rifreskuar i të gjitha rrugëve rajonale duke mundësuar njohjen në kohë reale të nevojave për investim



Zëvendëskryeministri, Gazmend Oketa

dhe për mirëmbajtjen e tyre. Zv/kryeministri Oketa tha se, komponentët kryesorë të këtij projekti do të jenë përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit dytësor dhe lokal të rrugëve në gjithë Shqipërinë, futja e kon-

tratave të mirëmbajtjes duke kontraktuar sektorin privat për rrjetin lokal të rrugëve, fuqizimin e organizmave përgjegjës për manaxhimin e rrjetit rrugor lokal, dhe konsolidimin e përgjegjësisë institucionale për

manaxhimin dhe planifikimin nga sektori i rrugëve sekundare.

## Kontrata

Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Benet Beci, foli rreth aktiviteteve kryesore dhe hapat e ardhshëm për

## ELBASAN

### Abuzimi me energjinë, në 5 muaj gjobiten 102 subjekte

Të paktën 102 subjekte private apo konsumatorë familjarë në qarkun e Elbasanit janë gjobitur nga muaji korrik dhe deri tani për abuzime me energjinë elektrike. Aksionet në këtë drejtim janë marrë nga dega e Shërbimit të Kontrollit të Energjisë Elektrike në qarkun e Elbasanit (SHKEE) në bashkëpunim me Agjencitë Teknike në Elbasan, Librazhd e Peqin. Kryetari i degës së SHKEE-së, Refik Bozhiqi, në një prononcim tha se "vetëm gjatë muajit nëntor u ndëshkuan me gjoba 14 subjekte private dhe 7 konsumatorë familjarë". Duke iu referuar kontrolleve nga muaji korrik dhe deri tani, ai bëri të ditur se janë ndëshkuar me gjoba gjithsej 50 subjekte private dhe 52 konsumatorë familjarë. "Falë denoncimeve nga qytetarë të ndryshëm kemi konstatuar 21 lidhje abuzive, 11 abonentë pa kontratë si dhe 20 çënime të sistemit matës", shtoi Bozhiqi. Përsa i takon nivelit të arkëtimit të gjobave ai tha se "ato janë vjelë në masën 98.7%". Sipas kryetarit të SHKEE-së "gjatë muajit dhjetor do të punohet për arkëtimin e akteve të prapambetura të aplikuar nga policia elektrike".

fillimin e punës. Objektivi i FSHZH-së është lidhja e kontratave të para të punimeve civile në periudhën korrik-qershor 2008. I gjithë projekti do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë e Qeverisjes Vendore. Sipas Becit, kriteret kryesore për përzgjedhjen e projekteve për financim do të përfshijnë:

"ndikimin e projektit në zhvillimin social e ekonomik të zonës, gjendja ekzistuese e rrugës së propozuar, numri i përfituesve, raporti financiar kosto/përfitim, etj". Kriteret do të bëhen publike para vlerësimit dhe do të konsultohen me të gjithë të interesuarit në mënyrë që të arrihet një përzgjedhje sa më e mirë.